



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I46-2 Prot.
Nr. Dok. 202502870/

Tiranë 17/12/2025

Lënda: Rekomandim në lidhje me monitorimin në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut, Linzë.

Drejtuar: Znj. Suela ASLLANI
Drejtore
Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut, Linzë

TIRANË

Për dijeni: Drejtorit të Përgjithshëm të
Shërbimit Social Shtetëror

TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi gjetjet dhe rekomandimet nga monitorimi që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut në vijim (QKPVT) Linzë.

Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, më datë 04.06.2025 kreu një inspektim në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut në vijim "QKPVT" Linzë, sipas një Plani Vjetor Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Nertila Qafzezi dhe znj. Gloria Çarkaxhiu me detyrë Nd/komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Objektivi kryesor i kësaj vizite monitoruese ishte vlerësimi i kushteve të QKPVT Linzë, cilësia, mënyra e trajtimit të personave brenda saj, si dhe masat e marra për

zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Grupi i inspektimit u takua me drejtuesen znj. Suela Asllani si dhe me stafin e qendrës të cilëve iu shpjegoi qëllimin dhe metodologjinë e inspektimit. Nga ana e stafit, ekspertëve të grupit inspektues iu ofrua mundësia që të kishin akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që duhet të monitoronin.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Avokati i Popullit ka detyrimin ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë:

Shënime të përgjithshme

Inspektimi u krye në përputhje me procedurën e monitorimit të Mekanizmit Kombëtar. QKPVT është pjesë përbërëse e rrjetit të institucioneve të përkujdesit shoqëror të administruara nga Shërbimi Social Shtetëror. Kjo qendër ka si mision përmirësimin e statusit social të viktimave të mundshme të trafikimit, ndërgjegjësimin dhe aftësimin e tyre për jetesë të pavarur në komunitet, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të procesit të vetëvlerësimit, të luftës së stigmës dhe diskriminimit që kanë efekt të drejtpërdrejtë në riintegrimin e plotë. Qëllimi i kësaj qendre është rehabilitimi i viktimave të trafikut ose të identifikuar si potencial trafikimi. QKPVT u ofron përfituesve një vendqëndrim të përkohshëm të sigurt, jashtë rrezikut, duke ofruar në të njëjtën kohë, ndihmë të specializuar për riaftësimin dhe rikthimin në jetën normale.

QKPVT është pjesë përbërëse e Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror të administruara nga Shërbimi Social Shtetëror. Veprimtaria e këtij institucioni është bazuar në politikat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. QKPVT është krijuar dhe zhvillon veprimtarinë e saj në zbatim të VKM-së nr. 589, datë 28.08.2003, “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit”, ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, VKM nr. 658, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve shoqërore”, VKM nr. 195, datë 11.04.2007, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi” në Konventën për të Drejtat e Njeriut, si dhe në Strategjinë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale.

Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit ka këto objektiva kryesore:

- ✓ Përmirësimi dhe zhvillimi i jetës dhe gjendjes social-psikologjike, ekonomike, kulturore etj., të viktimave të trafikimit apo rrezik trafikimi, nëpërmjet

shërbimeve sociale, psikologjike, juridike, mjekësore, arsimore, sigurisë për jetën, kualifikime profesionale, argëtuese etj., që zhvillohen në qendër.

- ✓ Rritjen e nivelit të cilësisë dhe të shërbimeve, aktiviteteve bashkëkohore në përputhje me misionin dhe standardet kombëtare të punës për viktimat e trafikimit në qendrat rezidenciale.
- ✓ Zbatimi i detyrave dhe akteve ligjore dhe nënligjore që dalin në kuadër të zbatimit të Strategjisë së luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore.
- ✓ Kooperimi dhe rritja e bashkërendimit të veprimeve me institucionet shtetërore, organizatat dhe OJQ-të, të huaja dhe vendase, që punojnë në fushën e luftës kundër Trafikimit të qenieve Njerëzore.
- ✓ Rritja e bashkëpunimit me familjen për të realizuar kthimin e viktimave në familje, në rastet kur është e mundur, në kuadër të deinstitutionalizimit të shërbimeve.
- ✓ Rritja e bashkëpunimit me pushtetin vendor për realizimin sa më të mirë të procesit të monitorimit për riintegrimin e viktimave të trafikimit në familje apo në komunitet.
- ✓ Dhënia e ndihmës viktimave të mundshme të trafikimit për të zhvilluar një ndjenjë kontrolli mbi jetën e tyre dhe për të kuptuar gjendjen e tyre aktuale dhe atë që kanë kaluar, si dhe për të shkuar drejt një ndryshimi konstruktiv.

Shërbimet që ofron Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit

QKVT realizon shërbime dhe ndihmë për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit duke ofruar: ushqim, veshje, strehim të përkohshëm, nivel të lartë sigurie, asistencë psiko-sociale, asistencë të specializuar psikologjike, asistencë mjekësore, asistencë ligjore, edukim arsimor, zhvillimi i potencialeve nëpërmjet trajnimeve dhe kualifikime profesionale, aktivitete rehabilituese dhe riintegruese, referim për riintegrim, përgatitje për riintegrim në familje, bashkëpunim me aktorë të tjerë për monitorim dhe vlerësim i viktimave të mundshme të trafikimit gjatë procesit të riintegrit.

QKVT përbëhet nga dy godina, një godinë për administratën dhe një godinë investim i ri me fondet e Ambasadës Amerikane dhe Ushtrisë Amerikane, e vënë në funksion për akomodimin e përfituesve. **Përfituesit po marrin shërbim në godinën e re, godinë e cila ka filluar funksionin që nga Maji i vitit 2024.**

Për periudhën janar – maj 2025 janë asistuar: 15 raste gjithsej (raste të mbartura nga viti 2024) të ndara sipas target-grupeve: 15 viktima trafikimi ose në rrezik trafikimi me kombësi shqiptare dhe të huaj të cilët janë burra.

- 3 minorenë dhe 12 madhorë;
- 3 viktima të mundshme trafikimi me kombësi Shqiptare;

- 11 viktima të mundshme trafikimi me kombësi të huaj (Ukrainë);
- 1 viktimë e mundshme trafikimi me kombësi të huaj (Bjellorusi).

Gjatë periudhës janar-maj 2025 në qendër nuk ka patur asnjë rast të ri të referuar nga instancat identifikuese dhe referuese. Nga inspektimi i kryer evidentojmë se nga dhjetori i vitit 2024 QKPVT po trajton vetëm viktima meshkuj. Më datë 18 dhjetor 2024 u informuam se qendra është udhëzuar nëpërmjet kontakteve telefonike si dhe një email nga Shërbimi Social Shtetëror, për akomodimin e 12 shtetasve ukrainas viktima të mundshme trafikimi pranë QKPVT. Nga ana e stafit drejtues ishin marrë masa urgjente për referimin e sigurt të rasteve gra që trajtoheshin në qendër pranë organizatave partnere. Më datë 20 dhjetor 2024, 12 shtetasit e huaj, të gjithë adult (18-40 vjeç) janë akomoduar pranë QKPVT, të referuar nga Policia e Vlorës si dhe qendra Vatra Vlorë.

Nga informacioni i grumbulluar në vend, nga kontakti me stafin e institucionit si dhe nga këqyrja e dokumentacionit, e objekteve dhe mjediseve, rezultoi se rekomandimet e lëna nga Avokati i Popullit pas inspektimit të bërë në vitin 2024¹, kanë gjetur zbatim si më poshtë:

- ✓ Ishin marrë masat për plotësimin e organikës me pozicionin vakant të Mjekut, (vakanca është plotësuar më datë 25.10.2024).
- ✓ Ishin marrë masa për vendosjen në ambientet e qendrës të posterave, me të drejtat ligjore të përfituesve të akomoduar në qendër.
- ✓ Ishin marrë masa për etiketimin e kampionëve ushqimorë sipas përcaktimeve ligjore.
- ✓ Ishin marrë masa për blerjen e pajisjeve dhe orendive të reja.

Sa më sipër, Avokati i Popullit vlerëson qasjen bashkëpunuese të Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut ndaj rekomandimeve dhe përpjekjet e vazhdueshme për plotësimin e standardeve.

Trajtimi

Grupi i inspektimit kishte si objektiv të punës së tij mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e përfituesve të strehuar në qendër, në identifikimin e rasteve të përdorimit të forcës fizike, apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie. Nga

¹ Rekomandim Nr.K4/I64-2, Prot Dt.24.12.2024, “Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të viktimave të mundshme të trafikimit në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut, Linzë”.

informacioni i marrë, grupi inspektues nuk konstatoi ndonjë rast torture, trajtimi të papërshtatshëm apo përdorimi të tepruar të forcës fizike.

Numri i personelit në këtë qendër është 16 punonjës, nga të cilët 5 punonjës socialë, 1 mjek, 1 psikolog, 1 edukator, 1 kujdestare, 1 jurist dhe 6 punonjës në detyrat, magazinier mirëmbajtës, shofer, kuzhinier, sanitar.

Asistenca psiko-sociale realizohet dhe përmbushet përmes shërbimit dhe raporteve psiko-sociale nga personeli i specializuar. Punonjësit social të cilët kanë edhe rolin më të madh në këtë qendër kryenin vlerësimin e nevojave të identifikuara dhe hartojnë programe të ndërhyrjes, këshillimin individual dhe në grup për mbrojtjen e interesave individuale të përfituesve. Aktivitetet për përfitueset synonin organizimin e punës në grup dhe bashkëpunim çka rriste ndjeshëm dhe cilësinë e shërbimit ndaj tyre.

Qendra pritëse ka realizuar shërbimet si më poshtë:

Asistencë dhe intervistim të viktimave të trafikimit, potencial për trafikim apo të dyshuara si të tilla, pranë Drejtorisë së Policisë Tiranë, si dhe në Komisariatet në Tiranë.

Lidhur me shërbimet mjekësore, juridike, psikologjike janë lidhur kontrata bashkëpunimi me drejtorinë e QSUT-së, ISHP-së, klinikën “Aldent”, institucione të cilat kanë ofruar bashkëpunim në dhënien e ndihmës për viktimat e trafikimit.

Lidhur me ri-integrimin e viktimave është vepruar në bazë të referimit pranë organizatave të shoqërisë civile.

Për të gjitha viktimat e trafikut që kanë shprehur vullnetin dhe dëshirën e tyre për të filluar një jetë të pavarur larg familjes është mundësuar referimi dhe ri-integrimi i tyre pranë organizatave “Vatra Vlorë”, “Të ndryshëm dhe të barabartë”, në Tiranë.

Asistenca mjekësore kryhej nëpërmjet QSUT-së në të cilën ishte realizuar vlerësimi i nevojave mjekësore të përfituesve në momentin e akomodimit në qendër. Gjithashtu në bashkëpunim me shërbimet shëndetësore rajonale ishin plotësuar dosjet mjekësore të përfituesve dhe hapur kartelat shëndetësore për to. Ilaçet ishin siguruar përmes blerjeve të vogla, sipas nevojave specifike të personave që trajtohen në këtë qendër. Në rastet emergjente shëndetësore, përfitueset ishin shoqëruar për trajtimin e tyre në spital apo tek specialisti.

Gjatë inspektimit në QKPVT, nuk u paraqitën ankesa lidhur me trajtimin, ushqimin apo për probleme dhe shqetësime të tjera. Koha e qëndrimit të personave në këtë Qendër varionte nga 3 muaj deri në një vit. Sipas procedurës, grupi ndërdisiplinor trajtonte çdo rast specifik deri në përfundimin e gjykimit dhe integritet të viktimës së mundshme të trafikimit.

Masat mbrojtëse

Nga intervistimet e bëra nga grupi i inspektimit rezultoi se të gjithë përfituesit e akomoduar në QKPV të Trafikut ndodheshin aty si viktima të mundshme të trafikimit. Një rëndësi të veçantë përgjatë inspektimit kishte dhe shpërndarja e informacionit nga ana e stafit të qendrës drejt përfituesve në lidhje me shërbimet që ofrohen dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Për të garantuar sigurinë e jetës së banoreve, që trajtoheshin në qendër, ishte instaluar dhe funksiononte një sistem monitorimi me kamera, si për ambientet e jashtme ashtu dhe për ato të brendshme. Siguria e qendrës mbështetej nga forcat policore të Ministrisë së Brendshme, në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit e cila është përgjegjëse direkte për sigurinë brenda dhe jashtë perimetrit të qendrës me mbulim 24-orë. Mbrojtja e përfituesve mbështetej në evidentimin dhe plotësimin e nevojave të veçanta, bazuar në vlerësimin e gjithë jetës së përfituesve, aspekteve emocionale, fizike, arsimore, sociale, gjinore etj.

Sistemi i ankesë/kërkesave funksiononte konform akteve normative në fuqi. Ankesat e banorëve depozitoheshin në një kuti të posaçme, e cila hapej një herë në muaj nga punonjësit e Shërbimit Social Shtetëror. Në rastet kur ankesat kishin karakter urgjent, ankueset takoheshin drejtpërdrejtë me drejtuesen e institucionit.

Nga verifikimi i dosjeve të përfituesve nga grupi i inspektimit pasqyrohej në to: Proces-Verbal i akomodimit i nënshkruar nga tre palët pjesëmarrëse në procesin e intervistimit dhe identifikimit në organet referuese kryesisht Policia e Shtetit; Interviste paraprake; Deklarate akomodimi; Intervistë e kompletuar me të dhënat lidhur me procesin e trafikimit të përfitueses; Vlerësimi i nevojave të përfitueses nga ekipi multidisiplinor; Plani i ndihmës, i cili përfshin të gjitha aktivitetet dhe shërbimet që janë parashikuar të realizohen për plotësimin e nevojave, të identifikuar nga specialistet e fushës: akomodimi afat-gjatë, kualifikimi profesional, mbështetja juridike, mbështetja mjekësore, mbështetja arsimore, rubrika këto të përcaktuara në udhëzuesit e zbatimit të standardeve. Zhvillimi është realizuar nga ekipi multidisiplinor, i cili punon për përmbushjen e objektivave, aktiviteteve dhe indikatorëve personale. Plani i rehabilitimit të çdo përfituesi është i përcaktuar me afate kohore për përmbushjen e objektivave nga ekipi multidisiplinor dhe i firmosur nga të dyja palët. Rezultatet mujore të këshillimit nga

psikologu dhe punonjësi social. Raport përfundimtar i mbështetjes psikologjike. Raport përmbyllës i shërbimeve të ofruara dhe rezultateve të arritura gjatë kohë qëndrimit. Relacione takime me familjarë.

Vizitat me të afërmit realizoheshin dhe monitoroheshin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për siguri të lartë të përfituesve në qendër. Punonjësi që kishte në ndjekje rastin mbante kontaktet me të afërmit e viktimës së mundshme të trafikimit.

Në kuadër të ndërtimit të një sistemi për monitorimin e standardeve, grupi inspektues u informua se pas daljes nga qendra, personat e akomoduar në të, ktheheshin në familjet e tyre ose në strehëzat e ngritura nga OJF të ndryshme, të cilat i ndihmojnë në procesin e riintegrit të tyre dhe sistemit në jetën e përditshme.

Gjatë monitorimit në godinën dy katëshe, grupi i inspektimit konstatoi se ishin të afishuar postera të cilat të pasqyronin të drejtat e përfituesve të akomoduar në qendër.

Kushtet materiale

Në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut, Linzë në datën 07.05.2024 është vënë në funksion godina e re e ndërtuar me fondet e korpusit të inxhinierëve të Ushtrisë Amerikane.

Godina e re përbëhet nga 2 kate dhe ofron kushte komode për ofrimin e shërbimeve më cilësore ndaj përfituesve. Në katin e parë ndodhen kryesisht ambientet e përbashkëta si dhoma e ndenjës, kuzhina, mensa, atelieja, tualete si dhe zyrat e punonjësës sociale, mjekes, psikologes dhe koordinatores së sektorit social.

Në katin e dytë ndodhen dhomat e gjumit të cilat përbëjnë një kapacitet prej 40 shtretër. Të 13-të dhomat e banimit kishin kapacitet për akomodim deri në 3 përfituese. Ato paraqiteshin të pastra dhe të lyera rishtazi, të pajisura me krevate, dollapë dhe komodina.

Në katin e dytë gjithashtu gjenden dhe 2 ambiente të përbashkëta si salla e lojërave dhe salla e kompjuterëve. E gjithë godina ka 5 tualete, dushe si dhe 2 lavanteri.

Godina e re është e ndërtuar sipas të gjithë standardeve, është e pajisur me fikëse zjarri, detektorë tymi si dhe një sistem kamerash në ambiente të brendshme dhe të jashtme. Sistemi i ngrohjes mundësohet me kalldajë të brendshme, ndërsa ftohja e ambienteve kryhej me kondicionerët e instaluar nëpër ambiente.

Qendra ishte furnizuar rishtazi me produkte higjieno-sanitare si dhe ishin siguruar veshmbathjet e përshtatshme për përfitueset e të gjitha moshave dhe masave. Ndërkohë ishin në funksion makinat larëse dhe shërbimet e tjera sanitare, si dhe furnizimi me ujë të pijshëm ishte 24 orë.

Kuzhina, ishte e pajisur me mjetet e domosdoshme, ushqimi ishte i larmishëm dhe i bollshëm. Përgjatë inspektimit konstatuam se kampionët ushqimore emërtoheshin sipas vakteve ditore, në kushte frigoriferike sipas rregullores. Mensa ishte një mjedis brenda kësaj godine me rreth 8 tavolina ngrënieje në kushte të mira higjienike.

Dhoma e mjekut ishte e rregullt dhe e pajisur me një krevat vizitash, një dollap për mbajtjen e medikamenteve dhe një tjetër për mbajtjen e kartelave mjekësore për secilën përfituese.

Qendra nëpërmjet fondeve të përfituara nga projekti i përbashkët me Agjencinë e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara ishin krijuar ambiente funksionale si dhoma terapeutike ku viktimat marrin të gjithë ndihmën e duhur psikologjike, salla e lojërave e pajisur me fusha e minifusha lojërash si edhe salla e kompjuterëve.

Gjithashtu nëpërmjet këtyre fondeve në qendër është shtuar edhe një lavatriçe e re në ambientet e lavanterisë. Sipas standardeve, godina është e pajisur me fikse zjarri, detektorë tymi si dhe një sistem kamerash në ambiente të brendshme dhe të jashtme (19 kamera total). Gjithashtu sistemi i ngrohjes mundësohet më kalidajë të brendshme dhe ftohja nëpërmjet kondicionerëve.

Aktivitetet

Stafi i sektorit psiko-social ishte i përbërë nga 5 punonjës social dhe një psikologe. Ky staf, përveç aktiviteteve rehabilituese, planeve ndihmëse dhe konsultave individuale sipas rasteve, plotësonte dosjet me të dhënat personale të përfituesve dhe i administronte ato. Punonjësit socialë mbi bazën e vlerësimit të nevojave hartonin programe të ndryshme për të bërë të mundur integrimin e përfituesve në jetën sociale, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve dhe sinkronizimit të ndërhyrjeve.

Rehabilitimi për përfitueset kryhej me programe shërbim/këshillimi, individual dhe në grup. Punonjësit socialë shoqëronin përfitueset në takimet me familjarët dhe kurset profesionale. Psikologia në qendër hartonte skeda psikologjike lidhur me llojin e terapisë që përdorej, lojëra dhe aktivitete për zhvillimin psikologjik. Në bazë të nevojave individuale psikologu i shoqëronte përfitueset në seancat

gjyqësore dhe ndihma ligjore ofrohej nga juristi i qendrës. Qendra kishte edhe një bashkëpunim të mirë organizuar me qendrat; “Të ndryshëm dhe të barabartë”, Tiranë; “Tjetër Vizion”, Elbasan dhe “Vatra” në Vlorë.

Aktivitete për përfituesit në Qendër.

Aktivitetet për përfituesit në qendër synonin organizimin e punës në grup dhe bashkëpunimin dhe rritjen e profesionalizmit, rritje e cila ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë dhe suksesin e paketës së ndihmës e cila ofrohet për përfituesit. Për periudhën janar-maj të vitit 2025 janë siguruar:

1. Ushqim, veshje, strehim i përkohshëm (veshmbathje të reja sipas stinës);
2. Asistence psiko-sociale;
3. Asistence psikologjike;
4. Asistence mjekësore;
5. Asistence ligjore;
6. Edukim arsimor;
7. Zhvillimi i potencialeve nëpërmjet trajnimeve profesionale;
8. Kualifikime dhe trajnime profesionale (QRPKP nr.4-Tirane);
9. Nivel të lartë sigurie;
10. Aktivitete okupacionale, informuese, rehabilituese, riintegruese, argëtuese;
11. Referim për riintegrim;
12. Përgatitje për riintegrim.

Arsimimi- Bazuar në programet e Ministrisë së Arsimit: 3 përfitues kanë ndjekur orët mësimore nga edukatorja dhe stafi social për vitin shkollor 2024-2025, në bashkëpunim me shkollat ku rastet rezultojnë të regjistruar.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kohore të gjithë rastet shtetësve të huaj janë asistuar nga përkthyesi i licensuar, lidhur kryesisht me problematikat e çështjeve ligjore si dhe procesin hetimor.

Ndërkohë stafi ka asistuar të gjithë rastet e akomoduar për ndërmjetësimet me familjarët, komunikime të cilat janë realizuar kryesisht nëpërmjet kontakteve telefonike. Të gjithë rastet e akomoduar kanë patur kontakte telefonike me familjarët e tyre, evidentuar dhe në procesverbalin e telefonatave.

Ndihmë psiko-sociale, nëpërmjet këshillimeve individuale dhe në grup, lehtësimi psikoemocional, orientimit drejt përkujdesit ndaj vetes, realizimi i këshillimeve të vazhdueshme mbi problematikat e referuara nga vetë rastet, monitorim të vazhdueshëm, ndërmjetësim mbi menaxhimin e konflikteve, etj.

Referimi: Për gjatë muajve Janar- Maj 2025, **5 raste** të shtetasve të huaj janë larguar dhe janë asistuar në të gjithë procesin për referim në familje, me destinacion kryesisht në shtetin e Polonisë, **1 rast** në destinacion të panjohur nga stafi. Të gjitha rastet janë shoqëruar nga stafi dhe transporti i institucionit, deri në ambientet e brendshme të Aeroportit, Tiranë. **1 rast** (i mitur), është referuar pranë familjes, në qytetin e Tiranës, pas rivlerësimit të statusit VMT.

Gjatë periudhës janar-maj 2025 janë realizuar aktivitete me natyrë sportive dhe argëtuese si volejbol, basketbol, palestër, bilardo, shah, etj., aktivitete psiko-sociale, okupacionale si dhe informuese.

Janë realizuar gjithashtu 2 aktivitete me natyrë njohëse dhe argëtuese jashtë Institucionit

- në Malin e Dajtit;
- në Muzeun e Forcave të Armatosura.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe psikologjia e qendrës ka marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Aleanca LGBT-I “Ndikimi i traumës mbi përfituesit e shërbimeve tona”.

Shërbimi shëndetësor

Organika e qendrës ishte e plotësuar me mjek qendër me kohë të plotë. Përsa i përket rasteve për të cilat nevojitej konsultë e specializuar, shërbimi ofrohej pa vonesa nga mjekë specialistë të QSU “Nënë Tereza”, Tiranë.

Herë pas here në këtë institucion nevojitej edhe një vlerësim i specializuar i psikiatrit për shkak të specifikave dhe problemeve që mund të manifestoheshin nga përfitueset gjatë trajtimit në këtë qendër. Ky shërbim mund të ofrohej nga Qendra Komunitare e Shëndeti Mendor, e cila i përket zonës së mbulimit të këtij institucioni.

Medikamentet siguroheshin nëpërmjet një buxheti të veçantë të qendrës. Shërbimi stomatologjik kryhej rregullisht nga një subjekt privat, bazuar në marrëveshjen që kjo qendër kishte lidhur me klinikën përkatëse.

Institucioni nuk kishte një autoambulancë, në raste emergjente, përdorej makina e qendrës për transportimin e përfituesve pranë qendrave spitalore.

Gjithashtu shërbimi shëndetësor për këtë grup të shoqërisë, ka qenë në vëmendje të vazhdueshme nga institucionet shëndetësore, veçanërisht nga specialistë të

QSUT-së, drejtues të ISHP-së etj., të cilët në çdo moment kanë treguar gadishmërinë e tyre për asistencë mjekësore.

Për periudhën janar-maj 2025 janë kryer shërbimet mjekësore në funksion të ruajtjes së shëndetit të përfituesve të akomoduar në qendër si më poshtë:

- ✓ Vlerësimi primar së bashku me stafin multidisciplinar (15 raste);
- ✓ Marrja e të dhënave rreth statusit të tanishëm dhe të kaluar mjekësor për të gjitha përfitueset;
- ✓ Vlerësim objektiv dhe subjektiv duke gjykuar për nevojat e momentit janë akomoduar (15 raste);
- ✓ Ekzaminimet laboratorike (15 raste) (gjak komplet, bilanci biokimik, sëmundje infektive HbsAg, anti-HIV, Sifiliz, anti HCV), urinë komplet etj;
- ✓ Shoqërim për tek mjeku specialist, psikiatri (2 raste);
- ✓ Urgjencë mjekësore (viroza) (5 rast);
- ✓ Terapi mjekësore (5 raste);
- ✓ SST dhe parandalimi i tyre (1 rast);
- ✓ Aplikimi i terapisë nga infeksionistët (1 rast);
- ✓ Kontrollë të higjienës, mjediseve të përbashkëta, tualeteve, ambienteve të jashtme (oborre etj.);
- ✓ Radiografi kockore, pranë Spitalit Universitar të Traumës (3 raste).

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave për shtimin me staf mbështetës burra për turnin e natës lidhur me menaxhimin e rasteve.
2. Marrjen e masave për pajisjen e institucionit me autoambulancë, për t’ju përgjigjur në kohë situatave emergjente shëndetësore.

3. Marrjen e masave për blerjen e pajisjeve të reja për kompletimin e nevojave të institucionit në ambientin e kuzhinës.
4. Marrjen e masave të vazhdueshme për aftësimin profesional me qëllim fuqizimin e përfituesve në Qendër.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

**Mekanizmi Kombëtar për
Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër,
çnjerëzor ose poshtërues
(MKPT)**

AHMET PRENÇI